

RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE

**Për periudhën prill – qershor 2026
(Tremujori i dytë i vitit 2026)**

I. HYRJE

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Planin Vjetor të Punës për vitin 2026, buxhetin e aprovuar, kapacitetet profesionale dhe organizative në dispozicion, si dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat e privuar nga liria, ka vazhduar realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës prill–qershor 2026.

Aktivitetet e realizuara kanë pasur për qëllim garantimin e vazhdueshëm të qasjes në shërbime shëndetësore cilësore, të sigurta dhe të barabarta për të gjithë personat e privuar nga liria, përmes funksionimit të Njësive Shëndetësore të Burgjeve (NjShB), zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), fuqizimit të kapaciteteve profesionale, menaxhimit të rasteve komplekse shëndetësore dhe avancimit të vazhdueshëm të standardeve të kujdesit shëndetësor në institucionet korrektuese.

Gjatë kësaj periudhe, DShB ka bashkëpunuar ngushtë me Njësitë Shëndetësore të Burgjeve, Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK), institucionet publike shëndetësore, mekanizmat monitorues vendorë dhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim të sigurimit të një qasjeje të koordinuar, profesionale dhe të bazuar në të drejtat e njeriut.

Në të njëjtën kohë, janë realizuar aktivitetet e parapara në Planin e Punës për vitin 2026, duke iu përshtatur edhe situatës epidemiologjike, nevojave specifike shëndetësore të popullatës së burgosur dhe sfidave operative të identifikuara gjatë zbatimit të shërbimeve.

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës prill–qershor 2026, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka vazhduar funksionimin e plotë të shërbimeve shëndetësore në njëmbëdhjetë (11) Njësi Shëndetësore të Burgjeve, duke garantuar mbulim shëndetësor 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë për personat e privuar nga liria.

Gjendja e përgjithshme shëndetësore e personave të burgosur gjatë kësaj periudhe ka qenë stabile. Nuk janë evidentuar shpërthime të sëmundjeve ngjitëse apo situata epidemiologjike me ndikim të rëndësishëm në funksionimin e institucioneve korrektuese. Rastet shëndetësore me kompleksitet të shtuar janë menaxhuar përmes qasjeve multidisiplinare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve shëndetësorë dhe strukturave korrektuese.

Gjatë këtij tremujori:

- janë pranuar gjithsej **971 persona të rinj të privuar nga liria**;
- janë realizuar **14,734 shërbime shëndetësore**;
- janë kryer **4,614 vizita sistematike mjekësore**;

- janë realizuar **1,887 intervista psikologjike**;
- janë kryer **1,545 konsultime psikiatrike**;
- janë realizuar **208 analiza laboratorike**.

Një prioritet i veçantë gjatë kësaj periudhe ka qenë menaxhimi i shëndetit mendor dhe parandalimi i vetëlëndimeve dhe vetëvrasjeve. Në këtë drejtim:

- janë identifikuar 404 raste me rrezik potencial ose të shtuar për vetëvrasje;
- janë menaxhuar në mënyrë multidisiplinare të gjitha rastet e identifikuara;
- janë parandaluar me kohë tre (3) tentativa për vetëvrasje;
- është regjistruar një (1) rast i vetëvrasjes së realizuar, përkundër masave profesionale të ndërmarra.

Përdorimi i substancave psikoaktive vazhdon të paraqesë një sfidë të rëndësishme shëndetësore në sistemin korrektues. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar **128 raste të reja të përdorimit të drogave**, që përfaqësojnë **13.18% të personave të pranuar gjatë kësaj periudhe**. Programi i Trajtimit dhe Mirëmbajtjes me Metadon (TMM) ka vazhduar të zbatohet në të gjitha njësitë përkatëse, ndërsa gjatë këtij tremujori janë përfshirë **tetë (8) raste të reja** në këtë program.

Furnizimi me barna, materiale shpenzuese dhe pajisje mjekësore ka qenë i rregullt dhe pa ndërprerje. Të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve kanë qenë të furnizuara sipas kërkesave operative dhe nevojave të identifikuara.

Menaxhimi financiar gjatë kësaj periudhe është realizuar në përputhje me planifikimin buxhetor të aprovuar. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është menaxhuar me racionalitet dhe efikasitet, ndërsa aktivitetet në kategorinë e investimeve kapitale kanë vazhduar sipas procedurave të parapara.

III. REZULTATET KRYESORE

1. Avancimi i standardeve të kujdesit shëndetësor në burgje

DShB ka vazhduar përkushtimin për harmonizimin e praktikave të punës me standardet evropiane për kujdesin shëndetësor në institucionet korrektuese. Përmes zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit dhe mekanizmave të brendshëm të monitorimit është forcuar qasja e standardizuar në:

- pranimin dhe vlerësimin fillestar shëndetësor të personave të privuar nga liria;
- menaxhimin e rasteve me probleme të shëndetit mendor;
- parandalimin e vetëvrasjeve;
- trajtimin e përdoruesve të substancave;
- menaxhimin e sëmundjeve kronike;
- referimin dhe koordinimin me institucionet jashtë sistemit korrektues.

2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe vlerësimi nga Këshilli i Evropës

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Këshilli i Evropës: **“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”**,

DShB ka vazhduar aktivitetet për:

- zhvillimin dhe zbatimin e PSV-ve;

- trajnimin e stafit shëndetësor;
- fuqizimin e kapaciteteve profesionale;
- përmirësimin e menaxhimit të rasteve komplekse;
- zhvillimin e programeve për trajtimin e përdoruesve të drogave.

Një arritje e rëndësishme institucionale gjatë kësaj periudhe ishte prezantimi i modelit të organizimit dhe funksionimit të DShB-së në Konferencën e Këshillit të Evropës në Strasburg, ku modeli i kujdesit shëndetësor në burgje i Republikës së Kosovës u vlerësua si praktikë pozitive dhe shembull i një reforme të suksesshme institucionale.

Në këtë aktivitet, modeli i transferimit të shërbimeve shëndetësore nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë u prezantua si një përvojë e rëndësishme për garantimin e pavarësisë profesionale dhe integritetit të shërbimeve shëndetësore të burgjeve në sistemin publik shëndetësor.

Gjithashtu, koordinatori për shëndetin mendor i DShB-së është përzgjedhur si **ekspert shëndetësor nga EuroPris**, organizatë evropiane e administratave korrektuese, për kontribut në fushën e parandalimit të vetëvrasjeve dhe menaxhimit të shëndetit mendor në burgje.

ANALIZA E INDIKATORËVE SHËNDETËSORË, SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR DHE MENAXHIMI I RASTEVE ME RREZIK TË SHITUAR

IV. ANALIZA E AKTIVITETEVE SHËNDETËSORE DHE INDIKATORËVE KRYESOR

Bazuar në të dhënat statistikore të mbledhura nga të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve (NjShB) dhe analizën krahasuese me periudhën përkatëse të vitit paraprak, aktivitetet shëndetësore gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 paraqesin një vazhdimësi të qëndrueshme të funksionimit të sistemit shëndetësor në institucionet korrektuese.

Tabela numër 1, përmbledhje tre mujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Të dhënat mbi disa indikatorë të DShB, Prill - Qershor 2026		Muajt			Totali, tremujori i dytë 2026	Totali, tremujori i dytë 2025
Nr	Indikatori	Prill	Maj	Qershor		
1	Te burgosur te pranuar	342	304	325	971	1147
2	Te burgosur te liruuar	331	319	293	943	1014
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	342	307	325	974	1109
4	Konsulta mjekesore	2579	2070	2191	6840	7343
5	Konsulta psikiatrike	557	392	596	1545	1963
6	Konsulta psikologjike	596	602	689	1887	2163
7	Sherbime dentare	170	211	176	557	744
8	Sherbime te tjera mjekesore	1044	1138	1251	3433	4570
9	Totali i konsultimeve shendetesore	5138	4538	5058	14734	17400
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	9	10	11	30	21
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	8	11	12	31	35
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	222	236	235	693	739
13	Dergimet jashte IK per intervenime	14	16	18	48	53
14	Transferet shendetesore	13	16	5	34	26
15	Rastet me TBC	0	0	0	0	0
16	Rastet me HEPATIT B	0	0	1	1	0
17	Rastet me HEPATIT C	0	0	1	1	4
18	Rastet HIV pozitiv	0	0	0	0	1
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	126	124	154	404	547
20	Analizat e gjakut sipas planit	57	30	25	112	169
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	29	30	35	94	105
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	2	0	2	0
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1662	1599	1176	4437	4240
24	Kontrollet stomatologjike sistematike	22	31	14	67	60
25	Kontrollet gjinekologjike sistematike	4	4	5	13	16
26	Mamografi	0	0	0	0	0
27	PAPA test	0	0	0	0	0
28	RTG Pulmo	29	36	32	97	113
29	Neurotic Syndromes	212	192	209	613	777
30	Psychotic Syndromes	45	19	28	92	96
31	Semundjet kardiovaskulare	56	37	76	169	182
32	Semundjet Respiratore	88	83	74	245	326
33	Semundjet gastrointestinale	77	85	106	268	328
34	Semundjet urogenitale	42	41	32	115	102
35	Semundjet e lekures	66	53	80	199	229
36	SS te transmetueshme	0	2	0	2	1
37	Semundjet e sistemit lokomotor	78	82	71	231	309
38	Semundjet infektive	2	1	2	5	8
39	Vete lendimet	14	11	6	31	33
40	Lendimet trupore	31	18	28	77	108
41	Abuzimet seksuale	0	0	0	0	0
42	Rastet ne greve te urise	5	6	6	17	32
43	Tentim vetevrasjet	0	2	1	3	3
44	Vetmia - Izolimi	48	42	24	114	90
45	Vdekjet ne burg	0	0	1	1	0

Analiza e indikatorëve kryesorë dëshmon se shumica e aktiviteteve profesionale janë realizuar në përputhje me nevojat shëndetësore të personave të privuar nga liria dhe me kapacitetet ekzistuese të DShB-së.

Në aspektin epidemiologjik dhe organizativ, nuk janë evidentuar ndryshime domethënëse që do të ndikonin në stabilitetin e shërbimeve shëndetësore. Trendi i përgjithshëm i aktiviteteve ka qenë stabil, me disa ndryshime të pritshme që lidhen me numrin e personave të pranuar, qarkullimin e të burgosurve dhe kompleksitetin e rasteve shëndetësore.

Përfundimet kryesore nga analiza krahasuese e indikatorëve:

1. Stabiliteti i aktiviteteve shëndetësore

Aktivitetet shëndetësore gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 kanë ruajtur një trend të qëndrueshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Megjithëse është evidentuar një numër më i ulët i personave të pranuar në sistemin korrektues krahasuar me periudhën krahasuese, numri dhe struktura e shërbimeve të ofruara kanë qenë proporcionale me numrin e personave të privuar nga liria dhe me nevojat e tyre shëndetësore.

2. Vizitat mjekësore dhe shërbimet diagnostikuese

Gjatë kësaj periudhe është ruajtur niveli i ofrimit të:

- vizitave mjekësore;
- konsultimeve specialiste;
- shërbimeve stomatologjike;
- shërbimeve psikologjike dhe psikiatrike;
- analizave laboratorike;
- ekzaminimeve sipas indikacioneve klinike.

Krahasuar me periudhën paraprake, nuk janë evidentuar dallime statistike të rëndësishme në raport me numrin e personave të trajtuar.

Një rritje e rëndësishme është evidentuar në numrin e **vizitave sistematike shëndetësore**, duke reflektuar përkushtimin e DShB-së në zbulimin e hershëm të problemeve shëndetësore dhe menaxhimin preventiv të tyre.

3. Sëmundjet ngjitëse dhe monitorimi epidemiologjik

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, situata epidemiologjike në institucionet korrektuese ka qenë stabile.

Nuk janë evidentuar shpërthime epidemike apo raste të sëmundjeve ngjitëse që do të kërkonin ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Rastet e evidentuara, kryesisht: skabies; pedikulozë (morrat e kokës); dhe infeksione të tjera të zakonshme, janë menaxhuar sipas Procedurave Standarde të Veprimit dhe masave parandaluese të përcaktuara.

Raportimi i rasteve është realizuar përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), në përputhje me kërkesat ligjore dhe epidemiologjike.

4. Lëndimet trupore dhe siguria e personave të privuar nga liria

Gjatë kësaj periudhe është evidentuar një trend më i favorshëm sa i përket numrit të lëndimeve trupore krahasuar me periudhën paraprake.

Rastet e identifikuara janë menaxhuar në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit, duke përfshirë:

- vlerësimin fillestar mjekësor;
- dokumentimin profesional;
- trajtimin adekuat;
- referimin sipas nevojës.

Tabela numër 2. Shërbimet shëndetësore jashtë IK për periudhën raportuese

Daljet jashtë Institucionit Korrektues për arsye shëndetësore në ShSKUK, gjatë 3m2, 2026				
Nr	Shërbimet	Personat	IPFK	Hospitalizime në ShSKUK
1	400	323	94	13

V. SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

Shërbimet e shëndetit mendor vazhdojnë të përbëjnë një nga komponentët më të rëndësishëm të kujdesit shëndetësor në burgje, për shkak të prevalencës së lartë të çrregullimeve psikike, historisë së traumave, përdorimit të substancave dhe rrezikut të shtuar për vetëlëndim apo vetëvrasje.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, shërbimet e shëndetit mendor kanë vazhduar funksionimin e tyre në të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve, duke ofruar:

- vlerësim psikologjik fillestar;
- ekzaminim të statusit mendor;
- këshillim dhe mbështetje psikologjike;
- ndërhyrje krizash;
- monitorim të rasteve me rrezik;
- trajtim psikiatrik;
- psikoedukim;
- mbështetje për riintegrim social.

Shërbimet janë ofruar në mënyrë fleksibile, përmes kombinimit të punës individuale në ambiente profesionale dhe ndërhyrjeve në pavijone apo hapësira të përshtatura brenda institucioneve korrektuese.

VI. KONTRIBUTI I SHËRBIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR NË KUADËR TË AKTIVITETEVE TOTALE SHËNDETËSORE

Gjatë periudhës raportuese, shërbimet e shëndetit mendor kanë përbërë: 23.29% të të gjitha shërbimeve shëndetësore të realizuara në institucionet korrektuese.

Kjo përqindje dëshmon rëndësinë e komponentës së shëndetit mendor në kujdesin shëndetësor të personave të privuar nga liria.

Tabela numër 3. Shërbimet e shëndetit mendor në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2026.

SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDORË TË OFRUARA NË BURGJE						
Nr	Tremujori i dytë i vitit	Shërbimi	Viti 2026 (3m2)	Përqindja - %	Viti 2025 (3m2)	Përqindja -%
1	2026	Konsulta shëndetësore	14734	100.00	17400	100.00
		Vizita psikiatrike	1545	10.49	2163	12.43
		Seanca psikologjike	1887	12.81	1963	11.28

Shërbimet kryesore kanë përfshirë:

- konsultime psikiatrike;
- intervista psikologjike;
- vlerësime klinike;
- terapi mbështetëse;
- psikoterapi;
- seanca psikoedukative;
- menaxhim të rasteve me rrezik të lartë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, si numri absolut ashtu edhe përqindja e shërbimeve të shëndetit mendor paraqesin një nivel të ngjashëm, duke treguar qëndrueshmëri të sistemit të ofrimit të këtyre shërbimeve.

VII. PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RASTEVE ME RREZIK PËR VETËVRAJSJE

Parandalimi i vetëvrasjeve vazhdon të jetë prioritet strategjik i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, është vazhduar me zbatimin e plotë të:

- Procedurës Standarde të Veprimit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje;
- vlerësimit sistematik psikologjik;
- menaxhimit multidisiplinar të rasteve;
- hartimit të planeve individuale të trajtimit.

Vlerësimi psikologjik dhe identifikimi i hershëm

Procesi i vlerësimit është realizuar përmes përdorimit të mjeteve të standardizuara profesionale, përfshirë:

Tabela numër 4. Tabela e mjeteve zyrtare për vlerësim psikologjik në burgjet e Kosovë

BATERIA ZYRTARE E TESTEVE PSIKOLOGJIKE	NË DSHB
FUSHA E VLERËSIMIT	MJETI MATËS
Vlerësimi i konstrukteve dhe çrregullimeve bazë psikologjike	C.I
Vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së ankthit	BAI
Vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së depresionit	BDI
Vlerësimi i rrezikut për vetëvrasje	C-SSRS


Gjatë kësaj periudhe:

- janë realizuar 404 vlerësime psikologjike me mjete standarde;
- janë identifikuar 404 persona me nivele të ndryshme të rrezikut psikologjik;
- janë menaxhuar rastet përmes ekipeve multidisiplinare;
- janë përgatitur plane individuale të trajtimit.

Tabela numër 5. Paraqitja tabelore, sipas njësive, e rasteve të vlerësuara në aspekt psikologjik me mjete standarde, të vlerësuarve me rrezik për vetëvrasje, tentim vetëvrasjet, dhe e vetëvrasjeve të realizuara në burgjet e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2026

NjShB	Vlerësime psikologjike me mjete standarde	Tentim vetëvrasjet	Nr. i vetëvrasjeve të realizuara
Totali	404	3	1

Tabela numër 6. Paraqitja në grafikun e rasteve të vlerësuara në aspekt psikologjik me mjete standarde, tentim vetëvrasjet, dhe e vetëvrasjeve të realizuara në burgjet e Kosovës në tremujorin e dytë të vitit 2026



VIII. MENAXHIMI I TENTIM- VETËVRASJEVE DHE RASTEVE TË RËNDA

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026:

- janë regjistruar 3 tentativa për vetëvrasje, të cilat janë ndërprerë dhe menaxhuar me kohë nga stafi profesional;
- është regjistruar 1 rast i vetëvrasjes së realizuar.

Për çdo rast është realizuar:

- analiza profesionale;
- dokumentimi përkatës;
- raportimi institucional;
- shqyrtimi nga strukturat multidisciplinare;
- identifikimi i mundësive për përmirësimin e masave parandaluese.

MENAXHIMI I PËRDORIMIT TË DROGAVE, SHËRBIMET SPECIALE, BURIMET NJERËZORE DHE MENAXHIMI OPERACIONAL

IX. MENAXHIMI I PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE PSIKOAKTIVE DHE TRAJTIMI ME METADON

Përdorimi i substancave psikoaktive vazhdon të paraqesë një ndër sfidat kryesore shëndetësore në institucionet korrektuese, duke kërkuar një qasje të integruar, multidisiplinare dhe të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Tabela numër 7, përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik te DShB

Raportimi i tremujorit të dytë, për vitin 2026, për disa indikatorëve në burgje							Të dhënat për tremujorin e dytë të vitit 2025	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	342	304	325	971	100.00	1,147	100.00
2	Numri i duhanginjëve	222	202	201	625	64.37	636	55.45
3	Numri i abuzuesve të alkoolit	12	9	24	45	4.63	34	2.96
4	Numri i abuzuesve të drogave	38	40	50	128	13.18	128	11.16
5	Rastet me Hepatitis B	0	0	1	1	0.10	2	0.17
6	Rastet me Hepatitis C	0	0	1	1	0.10	4	0.35
7	Rastet me lëndime trupore	13	11	15	39	4.02	77	6.71
8	Rastet me TBC	0	0	0	-	-	-	-
9	Rastet me Diabet	10	5	6	21	2.16	24	2.09
10	Rastet me SST (AIDS)	0	0	0	-	-	-	-
11	Rastet me Hipertension Arterial	18	10	26	54	5.56	55	4.80

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka vazhduar zbatimin e programeve të trajtimit dhe rehabilitimit për personat e privuar nga liria me çrregullime të lidhura me përdorimin e substancave, duke kombinuar:

- vlerësimin mjekësor dhe psikiatrik;
- mbështetjen psikologjike;
- trajtimin farmakologjik sipas indikacioneve klinike;
- Terapinë e Mirëmbajtjes me Metadon (TMM);
- edukimin shëndetësor dhe mbështetjen për riintegrim.

Gjatë periudhës prill-qershor 2026, gjatë procesit të pranimit dhe vlerësimit fillestar shëndetësor janë identifikuar: 128 raste të reja të përdorimit të drogave, që përbëjnë: 13.18% të personave të pranuar në sistemin korrektues gjatë kësaj periudhe.

Ky indikator vazhdon të jetë i lartë dhe kërkon vazhdimësi në politikat parandaluese, trajtuese dhe rehabilituese.

Tabela numër 8, menaxhimi i drogave gjatë këtij tremujori në raport me të pranuarit në DShB;

Raportimi i tremujorit të parë, për vitin 2026, per disa indikatorëve ne burgje							Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2025	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	342	304	325	971	100.00	1,147	100.00
4	Numri i abuzuesve të drogave	38	40	50	128	13.18	128	11.16

Terapia e Mirëmbajtjes me Metadon (TMM)

Programi i Terapisë së Mirëmbajtjes me Metadon ka vazhduar të zbatohet në të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve ku ekzistojnë indikacionet klinike.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026:

- trajtimi është vazhduar për pacientët ekzistues;
- janë vlerësuar rastet e reja sipas kriterëve profesionale;
- janë përfshirë 8 raste të reja në programin TMM.

Menaxhimi i këtij programi është realizuar në koordinim ndërmjet:

- stafit mjekësor;
- psikiatërve;
- psikologëve klinikë;
- farmacistëve përgjegjës;
- strukturave drejtuese të institucioneve korrektuese.

Tabela numër 9, përmbledhje e TMM gjatë kësaj periudhe në DShB;

Raporti i shpenzimit të Metadonit për periudhën Prill - Qershor 2026						
Shkurtesat	Përshkrimi	Gjendja paraprake	Prill	Maj	Qershor	Totali
RV	Rastet ne Vazhdim	337	35	29	33	97
R	Rastet e Reja	71	1	2	5	8
RP	Rastet e Perseritura	42	1	8	7	16
RL	Rastet e Languara	61	5	5	10	20
TPz	Totali I Pozitave	538	42	44	55	141
	Totali I Mililitrave te Shpenzuar	62,833.00	6,722	6,908.00	6,908	42,295.50
	Totali I mililitrave te pranuar	48,400.00		9,000.00		39,400.00

Furnizimi me metadon është zhvilluar pa ndërprerje përmes sistemit të menaxhimit farmaceutik. Megjithatë, në disa njësi janë evidentuar vështirësi teknike në evidentimin e shpenzimit për shkak të problemeve në funksionalitetin e hyrjeve të sistemit nga Departamenti Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë. Çështja është adresuar tek strukturat përgjegjëse për gjetjen e zgjidhjes teknike.

X. MBËSHTETJA E SHËRBIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR NË PROCESIT E DERADIKALIZIMIT

Në kuadër të përpjekjeve institucionale për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në institucionet korrektuese, stafi i shëndetit mendor i DShB-së ka vazhduar të ofrojë mbështetje profesionale për komisionet multidisiplinare për deradikalizimin dhe rehabilitimin e personave të dënuar.

Aktivitetet janë realizuar duke u bazuar në:

- përvojat e fituara nga programet e mëparshme të mbështetura nga ICITAP;
- projektet e Këshillit të Evropës;
- praktikat evropiane për menaxhimin e rasteve me rrezik të lartë.

Kontributi i stafit të shëndetit mendor është fokusuar në:

- vlerësimin psikologjik të personave të përfshirë;
- identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe faktorëve mbrojtës;
- këshillimin profesional;
- hartimin e planeve individuale të ndërhyrjes;
- mbështetjen e procesit të riintegrit social.

Aktivitetet kanë qenë veçanërisht të rëndësishme në:

- Burgun e Sigurisë së Lartë;
- Qendrën Korrektuese të Dubravës.

XI. PROGRAMI KOMBËTAR PËR TRAJTIMIN E KRYERËSVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Njësia Shëndetësore e Burgut në Qendrën Korrektuese të Dubravës ka vazhduar kontributin profesional në kuadër të Programit Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës në Familje.

Psikologu klinik i certifikuar si fasilitator në këtë program ka vazhduar realizimin e aktiviteteve me personat e përfshirë, me fokus në:

- ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme;
- menaxhimin e emocioneve;
- zhvillimin e aftësive komunikuese;
- parandalimin e përsëritjes së sjelljeve të dhunshme.

DShB vazhdon të jetë e përfaqësuar në grupin profesional për hartimin dhe monitorimin e këtij programi në nivel kombëtar.

XII. INSTITUCIONI PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA - DUBRAVË

Institucioni për Kujdesin Shëndetësor të Personave me Nevoja të Veçanta në kuadër të Qendrës Korrektuese të Dubravës ka vazhduar funksionimin sipas qëllimit të përcaktuar, duke ofruar kujdes të specializuar për persona me:

- nevoja të veçanta fizike;
- sëmundje kronike që kërkojnë trajtim të vazhdueshëm;
- çrregullime psikiatrike;
- probleme të varësisë nga substancat.

Kapaciteti i këtij institucioni është: **81 vende të dedikuara.**

Ky institucion ka luajtur rol të rëndësishëm në:

- zvogëlimin e hospitalizimeve të panevojshme;
- trajtimin më human të personave me nevoja komplekse;
- ofrimin e terapisë okupacionale;
- integrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikosociale.

Tabela numër 10, të dhënat nga DShB lidhur me disa indikatorë, Qershor 2026;

Të dhënat nga DShB lidhur me disa indikatorë, Qershor 2026										
Nr	Institucioni	Indikator								
		> 65 vjet	%	Me nevoja të veçanta	%	Sëmundj e kronike	%	Raste me terapi për shëndet mendor	%	Gjendja numerike me 01.07.2025
1	NShB në Dubravë	34	4.26	34	4.26	117	14.66	158	19.80	798
2	NShB në Gërdovc	18	8.29	18	8.29	86	39.63	90	41.47	217
3	NShB në Smrekovnicë	6	10.17	6	10.17	29	49.15	14	23.73	59
4	NShB në Prishtinë	3	1.03	3	1.03	30	10.34	84	28.97	290
5	NShB në Gjiilan	1	0.80	1	0.80	20	16.00	38	30.40	125
6	NShB në Prizren		-		-	2	4.44	11	24.44	45
7	NShB në Mitrovicë	3	6.25	3	6.25	7	14.58	2	4.17	48
8	NShB në Pejë	2	3.45	2	3.45	9	15.52	14	24.14	58
9	NShB në QK të Miturve		-		-		-	2	5.56	36
10	NShB në QK të Femrave	1	2.50	1	2.50	7	17.50	6	15.00	40
11	NShB në QK të miturve të avansuar		-		-	2	6.67		-	30
12	Totali Qershor 2026	68	3.89	68	3.89	309	17.70	419	24.00	1746
13	Totali 2025	57	3.40	9	0.54	289	17.22	406	24.20	1670

XIII. MENAXHIMI I PERSONAVE ME ÇRREGULLIME MENDORE DHE SFIDAT AKTUALE

DShB ka arritur një stabilitet të konsiderueshëm në organizimin e shërbimeve të shëndetit mendor përmes:

- fuqizimit të stafit profesional;
- rritjes së numrit të psikologëve klinikë;
- angazhimit të psikiatërve konsultantë;
- standardizimit të procedurave të trajtimit.

Megjithatë, një sfidë e vazhdueshme mbetet numri i lartë i personave të paraburgosur me probleme serioze të shëndetit mendor, për të cilët gjykatat kanë nxjerrë vendime për vlerësim apo trajtim të detyrueshëm në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK).

Për shkak të kufizimit të kapaciteteve pranuese në IPFK, këta persona vazhdojnë të qëndrojnë në qendrat e paraburgimit, duke krijuar ngarkesë shtesë për:

- stafin shëndetësor;
- shërbimet psikologjike;
- menaxhimin korrektues.

Kjo çështje mbetet një nga prioritetet kryesore për koordinim ndërinstitutional ndërmjet:

- Ministrisë së Shëndetësisë;
- Ministrisë së Drejtësisë;
- ShKK-së;
- IPFK-së;
- institucioneve gjyqësore.

XIV. BURIMET NJERËZORE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Shërbimet shëndetësore në burgje gjatë kësaj periudhe janë ofruar përmes një ekipi multidisiplinar profesional.

Struktura e shërbimeve të shëndetit mendor ka përfshirë:

- 9 psikologë klinikë me orar të plotë pune;
- 3 psikologë klinikë konsultantë;
- 3 psikiatër me normë të plotë;
- 2 psikiatër me gjysmë norme;
- 7 psikiatër konsultantë.

Ky organizim ka mundur menaxhimin profesional të rasteve të zakonshme dhe komplekse.

Avancimi profesional i stafit

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar mbështetja për zhvillimin profesional përmes:

- specializimeve mjekësore;
- specializimeve në psikologji klinike;
- trajnimeve profesionale;
- programeve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP).

Në këtë kuadër:

- një mjek ka vazhduar specializimin në psikiatrinë e fëmijëve dhe adoleshentëve;
- një mjek ka vazhduar specializimin në psikiatrinë e të rriturve;
- psikologët klinikë kanë vazhduar procesin e specializimit;
- dy psikologe klinike kanë përfunduar specializimin dhe kanë marrë titullin specialist i psikologjisë klinike.

Raporti i kontrollës Higjienike në Burgje, Prill - Qershor, 2026			Burgjet											Totali	Rezultati Final
Nr	Njësitë	Parametrat specifik që inspektohen	Du brave	Lipjan 1	Lipjan 2	Lipjan 3	Prizren	Gjilan	Peja	Mitrovica	Prishtinë	Smrek	BSL		
1	Ambulalanta	Higjiena	4.00	5.00	5.00	4.33	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	5.00	52.33	4.76
2		Mbeturinat mjekësore	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	54.00	4.91
3		Barërart pa afat, kontrolli, evidenca	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	53.67	4.88
4		Stacionari, miëmabjtja, qarqafët, higjiena...	3.67	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	4.33	52.00	4.73
5	Depoja e ushqimit	Gjendja e depos	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.33	45.33	4.12
6		Temperatura	4.00	3.67	3.67	5.00	5.00	4.00	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	49.33	4.48
7	Kuzhina	Skadënca	5.00	5.00		4.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	5.00	48.00	4.36
8		Higjiena	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	4.00	4.33	4.67	4.33	46.33	4.21
9		Higjiena e hapësirave	4.00	3.33	4.00	4.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.67	4.67	3.67	46.33	4.21
10		Higjiena e pajisjeve	4.00	4.00	4.00	4.00	4.67	4.00	5.00	4.00	4.67	5.00	4.33	47.67	4.33
11		Higjiena e përpunimit të ushqimit	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	4.00	49.00	4.45
12		Kontrolli i cilësise (kualiteti dhe higjiena)	4.00	3.67	4.00	5.00	3.33	5.00	5.00	4.00	4.67	4.00	4.00	46.67	4.24
13		Kontrolli i lasisë (kalorive)	3.00	4.33	4.00	5.00	3.67	4.00	5.00	4.00	4.67	3.00	3.67	44.33	4.03
14		Marrja dhe ruajtja e mostres (72 orë)	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	55.00	5.00
15	Uji i pijes	Rrjedhshmëria	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.33	48.33	4.39
16		Cilësia	4.00	4.00	5.00	5.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.67	4.00	4.33	48.00	4.36
17	Stafi	Uniformat	4.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	4.00	4.00	5.00	2.67	4.33	45.00	4.09
18		Librezat Sanitare	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	52.67	4.79
19	Dhomat e banimit	Kushtet higjienike sanitare	4.00	3.00	4.00	5.00	4.67	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	44.67	4.06
20		Ndërrimi i qarqafëve 2 herë në muaj	3.00	4.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.00	47.00	4.27
21		Ndërrimi i batanijeve çdo 3 muaj	2.00	4.00	5.00	5.00	4.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	47.00	4.27
22		Larja e nërresave çdo javë	3.00	4.00	5.00	4.00	4.00	5.00	4.00	5.00	4.33	5.00	4.33	47.67	4.33
23		Mjetet higjienike personale	3.00	3.00	3.67	4.00	4.00	4.00	3.00	4.00	4.33	4.00	4.67	41.67	3.79
24	Nyjet sanitare	Mjete higjienike të dhomës	3.00	3.33	4.00	4.00	4.00	3.00	4.00	4.00	4.33	4.00	4.00	41.67	3.79
25		Hiigjiena	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	4.33	46.33	4.21
26		Uji i rrjedhshëm	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.33	48.33	4.39
27		Mjetet higjienike	3.00	3.33	4.00	5.00	4.00	3.00	4.00	4.00	5.00	4.00	4.67	44.00	4.00
28		Higjiena	3.00	3.33	4.00	5.00	4.00	3.00	3.00	4.00	4.67	4.00	4.33	42.33	3.85
29	Bnjot	Mjetet higjienike	3.00	3.33	4.00	5.00	4.00	3.00	4.00	4.00	4.67	4.00	4.33	43.33	3.94
30		Uji i rrjedhshëm	3.00	5.00	5.00	4.00	4.00	4.67	5.00	4.00	5.00	4.00	4.67	48.33	4.39
31	DDD	Frekuenca e larjes sipas specifikave	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	3.67	4.00	4.00	5.00	4.00	3.67	46.33	4.21
32		Dezinfektimi ditor	2.00	5.00	5.00	5.00	5.00	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	49.00	4.45
33		DDD e rregullt periodike, çdo 3 muaj	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	54.67	4.97
Totali, mesatarja për institucione			3.63	4.22	4.31	4.66	4.40	4.22	4.45	4.27	4.85	4.33	4.41	47.77	4.34
Mesatarja e vlerësimit të kushteve higjienike sanitare në burgje, (vlerat matëse nga 0 - 5)															

Masat parandaluese dhe menaxhimi i sëmundjeve ngjitëse

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar raste sporadike të:

- skabies;
- pedikulozës;
- infeksioneve të tjera të zakonshme.

Të gjitha rastet janë menaxhuar sipas protokolleve dhe Procedurave Standarde të Veprimit të DShB-së.

Janë ndërmarrë masa të shtuara higjienike në institucionet përkatëse, përfshirë:

- trajtimin e rasteve individuale;
- higjienizimin e ambienteve;
- kontrollin e kontakteve;
- monitorimin e vazhdueshëm epidemiologjik.

XVI. MENAXHIMI I SIGURISË USHQIMORE

Gjatë kësaj periudhe DShB, në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka filluar diskutimin institucional lidhur me menaxhimin e sigurisë ushqimore, veçanërisht për ruajtjen dhe trajtimin e produkteve ushqimore termolabile që sigurohen përmes kantinave të institucioneve korrektuese.

Qëllimi i këtij procesi është:

- reduktimi i rrezikut për intoksikacione ushqimore;
- forcimi i kontrollit të zinxhirit të ruajtjes së ushqimit;
- përcaktimi i përgjegjësiwe institucionale;
- hartimi i një modeli të standardizuar menaxhimi.

DShB është në proces të përgatitjes së një propozimi teknik për menaxhimin adekuat të kësaj çështjeje.

XVII. MENAXHIMI I BARNAVE DHE MATERIALIT SHËNDETËSOR

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, furnizimi me barna dhe materiale shëndetësore ka vazhduar në mënyrë të rregullt dhe pa ndërprerje.

Të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve janë furnizuar sipas kërkesave operative dhe nevojave të identifikuara.

Menaxhimi i barnave është realizuar përmes:

- sistemit SMSF;
- evidencave të brendshme farmaceutike;
- monitorimit të konsumit;
- kontrollit të daljeve ditore.

Monitorimi i përdorimit të barnave

Gjatë kësaj periudhe është realizuar monitorimi i punës së disa NjShB-ve, duke përfshirë:

- evidentimin e konsumit ditor;

- kontrollin e regjistrimeve farmaceutike;
- analizën e shpenzimeve;
- dhënien e rekomandimeve për përmirësim.

Të gjitha daljet e barnave janë realizuar në përputhje me procedurat dhe rekomandimet në fuqi.

Shpenzimet për barna dhe materiale shëndetësore

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 janë realizuar shpenzime në vlerë: 45,501.51 € për barna dhe materiale shëndetësore.

XVIII. FURNIZIMET DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitetet kryesore të menaxhimit kontraktual, përfshirë:

Pajisjet mjekësore

- Është realizuar servisi i aparaturave radiologjike:
 - RTG statik për imazhe;
 - RTG stomatologjik.

Servisimet janë realizuar sipas kontratave ekzistuese dhe kërkesat për pagesë janë proceduar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Furnizimi me gazra mjekësorë

Gjatë kësaj periudhe është nënshkruar kontrata e re për:

- oksigjen;
- azot;
- bombola;
- manometra;
- enë për azot.

Kontrata ka kohëzgjatje trevjeçare dhe siguron stabilitet më të madh në furnizim.

Materialet dhe pajisjet tjera

Janë realizuar:

- furnizimi me uniforma për stafin shëndetësor;
- furnizimi me materiale higjienike;
- furnizimi me letër A4;
- furnizimi me materiale administrative;
- procedurat për dosje mjekësore dhe protokolle.

XIX. MENAXHIMI BUXHETOR

Menaxhimi financiar i DShB-së gjatë kësaj periudhe është realizuar në përputhje me planifikimin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parësë.

Shpenzimet e realizuara gjatë periudhës raportuese janë:

Kategoria	Shuma
Pagat dhe mëditjet	435,635.13 €
Mallra dhe shërbime	108,959.75 €
Komunalitë	674.52 €
Gjithsej	545,269.40 €

Menaxhimi i buxhetit është karakterizuar nga:

- racionalitet në shpenzim;
- respektim i procedurave të prokurimit;
- monitorim i vazhdueshëm financiar;
- përdorim efikas i resurseve.

XX. EDUKIMI I VAZHÐUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Në kuadër të zhvillimit profesional të stafit shëndetësor, DShB ka vazhduar aktivitetet për akreditimin dhe realizimin e programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermierët.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026:

- janë organizuar 4 ligjërata profesionale;
- është monitoruar realizimi i planit vjetor të EVP-së;
- është vazhduar bashkëpunimi me Organizatën e Mjekëve të Kosovës (OMK) dhe Organizatën e Infermierëve të Kosovës (OIK).

XXI. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E NJËSIVE SHËNDETËSORE TË BURGJEVE

Gjatë kësaj periudhe është realizuar monitorimi i tetë (8) Njësive Shëndetësore të Burgjeve.

Monitorimi ka përfshirë:

- organizimin e punës;
- zbatimin e PSV-ve;
- menaxhimin e barnave;
- dokumentacionin shëndetësor;
- kushtet higjieno-sanitare;
- menaxhimin e ankesave.

Përveç monitorimeve fizike, është realizuar edhe:

- raportimi javor operacional;
- raportimi mujor higjieno-sanitar;
- komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e NjShB-ve.

XXII. TRAJTIMI I KËRKESAVE DHE ANKESAVE

Bazuar në procedurat në fuqi, gjatë kësaj periudhe DShB ka trajtuar kërkesat për informacione dhe raporte mjekësore nga institucionet dhe palët e autorizuar.

Janë dhënë:

- 18 përgjigje për Institucionin e Avokatit të Popullit;
- 3 përgjigje për avokatë;
- 13 përgjigje për palë të interesuara;
- 3 përgjigje për organe tjera juridike;
- 1 përgjigje për ambasada.

Gjithashtu është realizuar hapja dhe monitorimi i kutive të ankesave në: **8 Njësi Shëndetësore të Burgjeve.**

Tabela numër 12, përgjigjet e kthyer, sipas kërkesave:

Përgjigje për zyrën e IAP, avokatë, palë e organe juridike					
Nr	Muaji	Prill	Maj	Qershor	Total
1	Përgjigje për AP	5	5	8	18
2	Përgjigje për avokatë	1	0	2	3
3	Përgjigje për palë	6	4	3	13
4	Përgjigje për organe juridik	1	0	2	3
5	Përgjigje për ambasadë	0	0	1	1

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar dhe janë dhënë përgjigjet përkatëse sipas procedurave institucionale.

BURIMET NJERËZORE, BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL, PROJEKTET NDËRKOMBËTARE, AUDITIMI DHE REKOMANDIMET STRATEGJIKE

XXIII. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SFIDAT E STAFIT

Sigurimi i qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore vazhdon të jetë një nga faktorët kryesorë për garantimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore në institucionet korrektuese. Gjatë periudhës raportuese, DShB ka vazhduar funksionimin me kapacitetet ekzistuese profesionale, megjithatë janë evidentuar sfida të rëndësishme që lidhen me lëvizshmërinë e stafit shëndetësor, veçanërisht në profilet mjekësore dhe infermierore.

Këto sfida lidhen kryesisht me:

- largimin e stafit për arsye personale dhe profesionale;
- kërkesat e vazhdueshme për zhvillim profesional;
- nevojën për specializime të reja;
- konkurrencën me sektorin tjetër shëndetësor;
- vështirësinë në sigurimin e mbulimit të plotë të disa njësive.

Lëvizja e stafit shëndetësor

Gjatë kësaj periudhe:

- tre (3) mjekë kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, prej të cilëve:
 - dy (2) në NjShB Dubravë;

- një (1) në NjShB Prishtinë.

Kjo ka krijuar nevojë për masa të menjëhershme për riorganizim të shërbimeve dhe sigurimin e mbulimit të vazhdueshëm shëndetësor.

Situata paraqet rrezik të veçantë për:

- Qendrën Korrektuese të Gërdocit, për mbulimin e shërbimit mjekësor 24-orësh;
- Institucionin për Kujdesin Shëndetësor të Personave me Nevoja të Veçanta në Dubravë;
- Njësinë Shëndetësore të Burgut në Pejë.

Rekrutimi i stafit të ri

DShB ka ndërmarrë masat për plotësimin e vendeve të lira të punës.

Gjatë kësaj periudhe është përmbyllur konkursi për pozitat:

- mjek;
- stomatolog;
- fizioterapeut;
- laborant i biokimisë.

Procedurat e përzgjedhjes janë në vazhdim dhe synojnë fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale.

Gjithashtu, janë në proces procedurat për rekrutimin e:

- tre (3) mjekëve;
- një (1) stomatologu;
- një (1) infermieri;
- një (1) fizioterapeuti.

XXIV. BASHKËPUNIMI ME SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS (ShKK)

Bashkëpunimi ndërmjet Departamentit Shëndetësor të Burgjeve dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës ka vazhduar të jetë në nivel të mirë profesional dhe funksional.

Koordinimi i rregullt ndërinstytucional ka mundësuar:

- menaxhimin e rasteve komplekse;
- reagimin e koordinuar ndaj situatave emergjente;
- organizimin e shërbimeve shëndetësore;
- zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare;
- përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar nga liria.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar takime të rregullta koordinuese lidhur me:

- menaxhimin e rasteve individuale;
- sigurinë shëndetësore në institucione;
- procesin e riorganizimit dhe menaxhimit të mbylljes së Qendrës së Paraburgimit në Gjiilan.

XXV. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT DHE MEKANIZMAT MONITORUES

DShB ka vazhduar bashkëpunimin konstruktiv me Institucionin e Avokatit të Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar Kosovës për Parandalimin e Torturës (MKKPT)

Gjatë kësaj periudhe:

- janë trajtuar të gjitha kërkesat e adresuara;
- janë dhënë përgjigjet profesionale në afatet përkatëse;
- është vazhduar bashkëpunimi transparent me mekanizmat monitorues.

Është me rëndësi të theksohet se gjatë kësaj periudhe: DShB nuk ka pasur asnjë rekomandim të ri për zbatim nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Monitorimi i jashtëm është vlerësuar si mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe respektimin e standardeve për trajtimin human të personave të privuar nga liria,

.

XXVI. BASHKËPUNIMI ME KËSHILLIN E EVROPËS DHE REZULTATET NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të projektit: **“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”** të mbështetur nga Këshilli i Evropës, DShB ka vazhduar zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për forcimin e sistemit shëndetësor në burgje.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- hartimin dhe zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit;
- trajnimin e stafit;
- zhvillimin e kapaciteteve profesionale;
- përmirësimin e menaxhimit të rasteve të ndjeshme;
- zhvillimin e programeve për përdoruesit e drogave.

Konferenca e Këshillit të Evropës në Strasburg

Nga data **09–12 qershor 2026**, përfaqësuesit e DShB-së kanë marrë pjesë në Konferencën e Këshillit të Evropës në Strasburg, ku janë diskutuar:

- ndryshimet dhe avancimet në standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT);
- praktikat më të mira për kujdesin shëndetësor në burgje;
- zhvillimet në sistemet korrektuese evropiane.

Në këtë konferencë, Drejtori i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve ka prezantuar:

- modelin e organizimit të DShB-së;
- procesin e integritetit të shërbimeve shëndetësore të burgjeve në Ministrinë e Shëndetësisë;
- rezultatet e arritura pas reformës institucionale;
- përputhshmërinë me standardet e reja të KPT-së.

Modeli i Republikës së Kosovës është vlerësuar pozitivisht nga pjesëmarrësit dhe është konsideruar si një praktikë e suksesshme që mund të shërbejë si referencë për vendet tjera në proces të reformimit të shërbimeve shëndetësore korrektuese.

XXVII. AUDITIMI, INSPEKTIMET DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Gjatë periudhës raportuese DShB ka vazhduar bashkëpunimin me:

- Auditorin e Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Auditorin Kombëtar;
- Inspektoratin Farmaceutik;
- Inspektoratin Sanitar;
- strukturat tjera mbikëqyrëse.

Janë vazhduar aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve të auditimeve paraprahe, veçanërisht në:

- përmirësimin e procedurave administrative;
- menaxhimin e dokumentacionit;
- kontrollin teknik të shpenzimeve;
- forcimin e evidencave financiare.

Nga auditimi i jashtëm është evidentuar një gjetje lidhur me procedurën e pranimit fizik të inventarit gjatë shkarkimit të një furnizimi. DShB ka ofruar sqarimet përkatëse dhe ka theksuar se procesi final i pranimit është realizuar nga komisioni i autorizuar, i emëruar me vendim zyrtar dhe në përputhje me procedurat në fuqi.

XXVIII. KONKLZIONI I PËRGJITHSHËM

Bazuar në analizën e aktiviteteve të realizuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, mund të konstatohet se:

1. Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka vazhduar funksionimin stabil dhe profesional të shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet korrektuese.
2. Shërbimet shëndetësore janë ofruar në mënyrë të vazhdueshme, me mbulim 24-orësh dhe në përputhje me nevojat e personave të privuar nga liria.
3. Gjendja epidemiologjike ka qenë stabile, pa shpërthime të sëmundjeve ngjitëse me ndikim në funksionimin institucional.
4. Shërbimet e shëndetit mendor kanë vazhduar të jenë një komponent kyç i kujdesit shëndetësor, me fokus të veçantë në parandalimin e vetëvrasjeve dhe menaxhimin e rasteve komplekse.
5. Programet për trajtimin e përdoruesve të substancave, përfshirë Terapinë e Mirëmbajtjes me Metadon, kanë vazhduar me sukses.
6. Bashkëpunimi ndërinstitucional me ShKK, institucionet publike shëndetësore dhe partnerët ndërkombëtarë ka qenë faktor i rëndësishëm për realizimin e objektivave.
7. Modeli i organizimit të DShB-së vazhdon të vlerësohet si praktikë pozitive në nivel evropian.

XXIX. REKOMANDIME PRIORITARE

Për periudhën në vazhdim rekomandohet:

1. Vazhdimi i fuqizimit të burimeve njerëzore përmes rekrutimit dhe mbajtjes së stafit profesional.
2. Sigurimin e specializimeve për profesionistët shëndetësorë të DShB-së.
3. Forcimi i kapaciteteve për trajtimin e personave me çrregullime të rënda mendore dhe reduktimi i mbingarkesës së qendrave të paraburgimit.
4. Vazhdimi i zhvillimit të programeve të specializuara për përdoruesit e substancave psikoaktive.
5. Përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve digjitale për menaxhimin e barnave dhe të dhënave shëndetësore.
6. Vazhdimi i harmonizimit të praktikave të DShB-së me standardet e Këshillit të Evropës dhe KPT-së.
7. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin human, profesional dhe të bazuar në të drejta të njeriut të të gjithë personave të privuar nga liria.

Me respekt!